



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 08-134
09.04.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nënparagrafin 2 nga neni i njëjtë i Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), neni 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.124/15), dhe neni 42 paragrafi (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.96/19, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-134, datë 05.04.2024 për miratim të vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024, për heqjen e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.59/24), në pajtim me Konkluzionin, nr.02-1795/2, datë 09.04.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 14-të mbajtur më 08.04.2024 miratoi:

VENDIM

1. **Anullohet** Vendimi PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024 i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për heqjen e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023.

2. **DETYROHET** SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, më së voni deri më 09.04.2024 t'i përmbushë detyrimet financiare dhe të tjera edhe atë:

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 3.591,00 denarë me TVSH për publikimin e Vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), nr.59/24 - sipas faturës nr.2632-6849/27, datë 14.03.2024 (ark.nr.05-1330/1 datë 21.03.2024);

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 44.120,00 denarë me TVSH për publikimin e Vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023, në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së (sipas faturës nr. 33524/2024 datë 11.03.2024 (ark. nr. 05-1336/1 datë 21.03.2024) dhe faturës nr.2410300556 datë 08.03.2024 (ark.nr.0503-1178/1 datë 11.03.2024);

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 1.051,00 denarë me TVSH për publikimin Vendimit për fshirje nga regjistri i transmetuesve PA1 nr.0802-113, datë 13.03.2024, në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr.62/24 – sipas faturës nr.2832-6849/27 datë 19.03.2024. (ark.nr.05-1385/1 datë 25.03.2024);

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 3.591,00 denarë me TVSH për publikimin e Vendimit për anulimin e vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 në Gazetën Zyrtare të RMV-së;

- të tërheqë padinë e paraqitur në Gjykatën Administrative të RMV-së, më datë 26.03.2024 kundër Agjencisë, për anulimin e Vendimit PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024. për heqjen e lejes PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023.

3. Ky vendim hyn në fuqi me datë 09.04.2024, me kusht që SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, me kohë t'i përmbushë të gjitha detyrimet financiare dhe të tjera, që përmban pika 2 e këtij vendimi ndaj Agjencisë dhe për këtë të dorëzojë dëshmi në Agjenci.

Nëse radiotransmetuesi SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP nuk i përmbush detyrimet nga pika 2 e këtij vendimi në afatin e përcaktuar, mbetet në fuqi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr. 0803-63 i datës 04.03.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 dhe Fatura e kompensimit nr.2024-100-0096 datë 08.03.2024 (ark.nr.0503-1162/1 datë 08.03.2024), i cili është dhënë në bazë të këtij vendimi.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, regjistrohet në regjistrin e transmetuesve e drejtuar nga Agjencia.

5. Ky Vendim botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në uebfaqen e Agjencisë.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark nr.0201-1054/5, datë 01.03.2024, ka miratuar Vendimin PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023, për shkak se nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi 5 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin e lejes për radiotransmetim në afatin e përcaktuar me ligj.

Më datë 26.03.2024, drejtuar Agjencisë nga SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, është dorëzuar Njoftimi PA1 nr.08-63 i datës 26.03.2024, me fletëpagesë të bashkangjitur për pagesën e bërë sipas faturës ark.nr. 2024-100-0055 datë 11.01.2024 (ark. nr.0503-232/1 datë 11.01.2024), në shumë prej 15.474,00 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) denarë dhe kopje e padisë për ngritje të kontestit administrativ, në Gjykatën Administrative të RMV-së kundër vendimit PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102 e datës 07.09.2023.

Për sa mësipër, nga Sektori për financa dhe logjistikë, i dërgoi drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajçevskit, njoftim për pagesën e kryer të kompensimit të lejes nga SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, ark.nr.05-1756/1 datë 02.04.2024.

Sipas mundësisë ligjore që përmban neni 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe nenit 42 paragrafit 1 nga Ligji i Kontesteve

Administrative, SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, jo më vonë se 09.04.2024 duhet të përmbushë detyrimet e mëposhtme financiare dhe të tjera, edhe atë:

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 3.591,00 denarë me TVSH për publikimin e Vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), nr.59/24 - sipas faturës nr.2632-6849/27, datë 14.03.2024 (ark. nr.05-1330/1 datë 21.03.2024);

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 44.120,00 denarë me TVSH për publikimin e Vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-102, datë 07.09.2023, në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të PMV-së (sipas faturës nr.33524/2024 datë 11.03.2024 (ark. nr.05-1336/1 datë 21.03.2024) sipas faturës nr. 2410300556 datë 08.03.2024 (ark.nr. 0503-1178/1 datë 11.03.2024);

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 1.051,00 denarë me TVSH, për publikimin e Vendimit për fshirje nga regjistri i transmetuesve PA1 nr.0802-113, datë 13.03.2024, në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr.62 /24 - sipas faturës nr.2832-6849/27 datë 19.03.2024 (ark. nr.05-1385/1 datë 25.03.2024);

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 3.591,00 denarë me TVSH, për publikimin e Vendimit për anulimin e vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 në Gazetën Zyrtare të RMV-së;

- të tërheqë padinë e paraqitur në Gjykatën Administrative të RMV-së, më datë 26.03.2024 kundër Agjencisë, për anulimin e Vendimit PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023.

Nëse SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, nuk i përmbush detyrimet e cekura, në afatin e përcaktuar, atëherë mbetet në fuqi Vendimi PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-102, datë 07.09.2023 dhe Fatura e kompensimit nr.2024-100-0096 datë 08.03.2024. (ark.nr. 0503-1162/1 datë 08.03.2024), i cili është dhënë në bazë të këtij vendimi.

Duke pasur parasysh se SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, me pagesën e datës 26.03.2024, në shumë prej 15.474,00 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) denarë, plotësisht e ka përmbushur detyrimin për pagesën e kompensimit të lejes për radiotransmetim, ka pushuar të ekziston baza – mos pagesë të kompensimit në afatin e përcaktuar me ligj nga neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të LSHMAAV, në bazë të së cilës Këshilli i Agjencisë, ka marrë vendim për heqjen e lejes për radiotransmetim.

Në pajtim me nenin 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe neni 42 paragrafit 1 nga Ligji i Kontesteve Administrative, Këshilli i Agjencisë miratoi Propozimin PA1 nr.08-134, datë 05.04.2024 për marrjen e vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024, për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP PA1 nr.08-102 të datës 07.09.2023 dhe në seancën e 14-të, mbajtur më 08.04.2024 me Konkluzionin ark. nr.02-1795/2, datë 09.04.2024, ka miratuar Vendim me të cilin është ofruar anulimi i Vendimit PA1 nr.0803-63, datë 04.03.2024 të Këshillit të Agjencisë për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, nr.08-102 të datës 07.09.2023.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

Bazuar në sa mësipër është marrë Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi, SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.